



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANE

KËRKESË

PËR PUSHIMIN E ÇËSHTJES

GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR

TIRANË

Në përfundim të hetimit të procedimit penal nr.5073, të filluar në 27.07.2020, që ben fjale për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i K.P.

Nga hetimet e kryera rreth këtij kete procedimi penal ka rezultuar se: Më 02.07.2020, ka ardhur në ambjentet pranë Komisarariatit nr.6 shtetasi Selman dtl. 15.06.1990 i cili është shprehur se prej disa ditësh nuk kishte mundur të komunikonte me motren e tij Zhaneta Josifi dhe vajzat e saj, madje me vogel Anisa Josifi kishte me shume se dy vite që nuk e kishte takuar në pasur mundësi kontakti. Është ngitur grupi hetimor dhe kemi shkuar në banesën e shtetases Zhaneta Josifi në rrugën "Hamdi Cenojmeri". Pasi është trokitur te porta e tyre por nuk ka pasur reagime, është lajmëruar shërbimi i Zjarrit te bere te mundur hyrjen në banesë. Kur është hapur dera e banesës së Zhaneta Josifi janë konstatuar dy kufoma, perkatesisht te shtetaseve Zhaneta Josifi si dhe shtetësja Blerta Josifi e cila ishte në gjendje shëndetësore.

Është përpiluar kqyrja e vendit të ngjarjes ku është konstatuar kufoma e Zhaneta Josifi e cila ishte e ulur në gjunjë afër divanit të sallës ndërsa e gjumit mbi një krevat dopio vihet re kufoma e shtetases Anisa Josifi dekompozuar dhe e mbuluar me copa të ndryshme dhe me jorgan. Si dhe është vënë re prezencë e librave të ndryshëm fetar si dhe shënime të shkeputura nga Bibla në disa fletore.

I është marrë deklaram shtetasit Selman Fejzo në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale ku sqaron se ai është vëllai i shtetases Zhaneta Josifidhe prej disa kohesh motra e tij se bashku me dy vajzat kishin filluar të praktikonin besimin fetar. Ai deklaron se ka gati dy vite që nuk kishte komunikuar me vajzen e vogël Anisen dhe sa herë që pyeste motra e tij Zhaneta i thoshte se nuk gjendej në shtëpi dhe kishte pasur mundësi të komunikonte me të. Ai tregon se kunati i tij Dhimo Paskali kishte ardhur para disa muajsh në Polici dhe i kishte thënë se nuk po komunikonin dot me Anisen por kur Policia kishte shkuar në banesë shtetase Zhaneta i kishte thënë se Anisa është në një moshe madhore dhe nuk ka pasur mundësi të flasi me njëri-tjetrin por është shumë mirë dhe ka probleme. Ai tregon se në datë 02.07.2020 pasi kishin shkuar të banesa dhe nuk i është përgjigjur njëri-tjetri komunikuar me Policinë dhe me zjarrefiksen të cilët kanë bërë të mundur hyrjen në banesë dhe kanë gjetur kufomat si dhe Blerta Josifin në gjendje shumë të rëndë shëndetësore. Shtetasi Selman Fejzo tregon se me dijeninë e tij, motra dhe dy mbesat kishin me shumë se tre-katër vite që praktikonin një besim fetar por nuk dijeni ke besim fetar pasi ato nuk tregonin për jetën e tyre.

Është përpiluar vendimi për kryerjen e ekspertimit toksikologjik në lidhje me lëngjet që janë marrë në cilësinë e provës të gjtura në banesën e shtetases Zhaneta Josifi.

I është marrë deklaram shtetases Blerta Josifi në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale ku sqaron se ka jetuar se bashku me nënen dhe motrën e saj dhe e motra Anisa Josifi ka me shumë se 15 (pesezëdhjetë) muaj e cila kishte ndërruar jetën por për shkak të besimit të krishterë kufoma nuk mbante erë të keqe. Ajo tregon se në datën 03.06.2020 se bashku me nënen e saj kanë mbajtur argjirim duke mos ngrënë asnjë ushqim dhe që nga ai moment filloi të vinte era kufomes së motrës së saj Anisa. Gjithashtu sqaron se në banesën e tyre kanë mbajtur argjirim tëzja por ato nuk u kishin treguar gjë për i thoshnin se ishte e shtrirë. Arsyeja përse e kanë mbajtur motrën ka qenë prej vegimeve dhe besimit në Zot që ato kishin dhe se ajo do të ringjallej. Ndërsa e ëma e saj Zhaneta Josifi ka ndërruar jetën në datën 02.07.2020. Ajo tregon se treja kishin një besim të madh në Zot dhe ishin pjesë e Kishës Ungjillore por kishin rreth pesë vite që nuk shkonin me në Kishe. Shtetaseja Blerta Josifi tregon se motra e saj Anisa përpara se të ndërronte jetën kishte qëndruar rreth 52 ditë pa ngrënë e pa pirë dhe pas vdekjes ato nuk i thanë asnjë personi për vazhduan të mbanin trupin në banesë. Madje Blerta se bashku me të

emera e saj Zhaneten mendonin se nese do te benin ato nje sakrifice anisa do te rikthehej perseri ne jete. Ne muajin Mars 2020 Blerta se bashku me Zhaneten vendosen per te mbajtur nje argjirim, si sakrifice per te rikthyer Anisen ne jete dhe nga muaji qershor dhe aktualisht kane konsumuar vetem uje, rreth 30(tridhjetete) dite). Por ne date 02.07.2020 ajo tregon se ema e saj Zhaneta eshte ulur ne gjunje per tu lutur dhe me pas nuk ka reagur me. Ajo sqaron se asnje person tjetër nuk kishte dijeni per vdekjen e Anises dhe se i genjenin kusherinjte duke u thene se Anisa eshte shume mire nga ana shendetesore. Ajo tregon se Anisa perpara se te vdiste ishte e pushtuar nga demonet dhe ato nuk e cuan asnjehere per mjekim dhe per krizat e saj nervore kane qene ne dijeni vetem Zhaneta dhe ajo. Gjithashtu deklaroi faktin se asnje person nuk ishte ne dijeni per vdekjen e Anises as nga Kisha Ungjillore pasi kishin rreth pese vite qe nuk shkonin ne Kise por e kishin vazhduar vete trugetimin me Zotin.

Policia Gjyqesore ka kryer me procesverbalet e kqyrjes se kufomave te shtetases Zhaneta dhe Anisa Josifi dhe me pas eshte marre vendimet kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor ndaj shtetaseve Anisa Josifi dhe Zhaneta Josifi dhe trupat e tyre jane derguar ne Institutin e Policise Shkencore.

Ne baze te aktit te ekspertimit mjeko ligjore nr.399, date 11.08.2020, kryer nga eksperti mjeko ligjore Ilir Deçolli, i cili ka arritur ne konkluzionin se :

1. Ne trupin e kufomes se shtetases Zhaneta Josifi, nga kqyerja e jashtme nuk u konstatuan demtime te jashtme trupore. Nga kqyerja e brendeshme dhe ajo mikroskopike u konstatuan kaheksia nutritive, infarkt akut i miokardit, hepatit kronik agresiv, gjendje precipirike, edem e trurit, staze organesh me karakteristika e pershkruara me sipër.

2. Shkak i vdekjes se Zhaneta Josifit ka qene kaheksia nutritive me mekanizmin e infarktut akut te miokardit. Vdekja e shtetases Zhaneta Josifi ka ndodhur ne nje periudhe rreth 24 ore nga momenti i ekzaminimit.

Ne baze te aktit te ekspertimit mjeko ligjore nr.496, date 18.09.2020, kryer nga ekspertet mjeko ligjore Ilir Deçolli dhe Elton Serani te cilet kane arritur ne konkluzionin se :

1. Ne trupin e kufomes se shtetases Anisa Josifi, nga kryerja e jashtme dhe e brendeshme nuk u konstatuan shenja te dhunes fizike. Kufoma u gjend ne stadin e mumifikimit te plote. Nga ekzaminimi histologjik u konstatua autoliza te jetre e avancuar e organeve te brendeshme. Per shkak te autolizes se avancuar te organeve te brendeshme shkak u vdekjes se shtetases Anisa Josifi nuk mund te percaktohet me sakte shkenore, por me mundesine me te madhe vdekja duhet te kete ndodhur si pasqyre e kahesise nutritive me mekanizmin e infarktut akut te miokardit. Nisur nga stadi ne te cilin u gjend kufoma mendojme se vdekja e shtetases Anisa Josifi duhet te kete ndodhur ne nje periudhe kohore jo me pak se gjashte muaj nga dita e ekzaminimit nga ana jone.

Gjate kryerjes se veprimet hetimore ne banesen e shtetases Zhaneta Josifi kane sekuestruar ne cilsine e proves materiale dhe dy aparate te telefonit celulare. Me qellim perfundimor te dheneve nga keto dy aparate celulare, me shkruast numur 3735 vitit 2020, u jane kerkuar kompanive te telefonise celulare te dhenat ne lidhje me tabuletat e thirrjeve telefonike hyrse dhe dalje te numurave te telefonit celulare 0693873457 dhe numurit te telefonit celulare 0672001277.

Nga pergjigjet e ardhura nga Kompanite e telefonise Celulare "Vodafone Albania" dhe "One Comunikation" nuk ka rezultuar asnje e dhen me interes per hetimit. Nga te dy numurat e telefonit celulare nuk rezulton qe viktimat dhe shtetasja Blerta Josifi te kene patuar komunikime me ndonje person tjeter, ato kane komunikime vetem me njera tjeteren dhe me asnje person tjeter. Po keshtu nga verimet hetimore te kryera dhe nga pyetja e personave qe kane dijeni per rrethana te hetimit nuk rezulton qe ne banesen e ketyre shtetaseve te kete hyre ndonje person, ato i kane nderprere te gjitha komunikimet me jashte dhe po keshtu nuk kan lejuar asnje person te hyje ne apartamentin e tyre deri ne momentin qe policia ka shkuar ne banese dhe ka gjetur pa jete shtetaset Zhaneta dhe Anisa Josifi dhe ne gjendje te renduar shendetesore Blerta Josifi.

Nga hetimi nuk rezulton qe gjate kesaj periudhe ato te kene frekuentuar ndonje objekt fetare, e po keshtu nuk rezulton qe ne banesen e tyre te kete vajtur per vizite ndonje perfagesues i komunitetit fetare, si dhe nuk rezulton se te kene patur